



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni i posaçëm parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin European”

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.12.2024, ora 12:30

TRYEZË TEMATIKE PUBLIKE XI

Drejton tryezën: Jonida Rustemaj

Rendi i ditës:

Parandalimi dhe lufta kundër korrupsionit në sektorët me risk të lartë në qeverisjen qendrore dhe vendore.

Marrin pjesë:

Elisa Spiropali, Fatmir Xhafaj, Etilda Gjonaj dhe Esmeralda Dida.

Të ftuar:

Eda Noçka, Monika Canco, Nada Dollani, Jonida Rustemaj, Elona Hoxhaj, Zoran Jachev, Aleksander Maskovic, Arjan Dyrmishi, Tedi Dobi, Ilir Binaj, Xhoana Ristani, Insidor Rexhepi, Athanasios Kartalis, Diana Leka, Spiro Brumbulli, Nikolin Jaka, Xhiljola Baxheku, Bledar Mankollari, Niko Hyka, Odise Moçka, Silvana Ramadani, Isabelle Thomas Delic, Sokol Elmazaj, Florian Sulejmani, Dorina Kafexhiu, Delina Ibrahimaj, Ilda Muçmataj, Ardita Seknaj, Klara Kodra, Iris Aliaj, Klodian Mema, Andrino Allkas, Imir Kraja, Nadire Pilavi, Reald Keta, Stela Suloti, Marinela Jazoj, Brunilda Kostare, Eralda Disha, Kozeta Pinari, Vjosana Neziri, Blerina Çeloaliaj, Adriana Ristani, Adela Tagani, Majlinda Thomaj, Gentjana Zallumi, Silvana Saqe, Belioza Çoku, Pandi Madhi, Anxhela Bakiasii, Viktor Gjoni, Geri Pilaca, Elida Jata, Enkelejda Daja, Gentian Ndoi, Erisa Lame, Josi Ballauri, Alban Përmeti, Pajtim Melani, Ilia Bili dhe Lavdosh Ferruni.

HAPET MBLEDHJA

Jonida Rustemaj – Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra dhe përfaqësues të institucioneve,

Të nderuar përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, të organizatave të shoqërisë civile,

Ju falënderoj për pjesëmarrjen në tryezën XI të diskutimit publik, të organizuar në kuadrin e punës që po zhvillon komisioni i posaçëm parlamentar!

Kam nderin të moderoj këtë tryezë, e cila synon vjeljen e komenteve, sugjerimeve, në funksion të përmirësimit të draftit të analizës së përgatitur nga grupi i ekspertëve.

Panelin e ndaj me profesoreshë Nada Dollanin, pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë, njëherazi e angazhuar në shoqërinë civile, dhe me zonjën Eda Noçka, drejtoreshë Ekzekutive e Qendrës ALTRI.

Tema e tryezës së sotme lidhet me sektorët me risk të lartë korrupsioni, duke pasur si fokus prokurimin publik, partneritetet publike-private, koncesionet, tatimet dhe doganat.

Në fakt, prokurimi publik ngelet një veprimtari tejet e ekspozuar ndaj korrupsionit, për shkak të numrit të lartë të transaksioneve që realizohen në një kohë shumë të shkurtër, për shkak të kompleksitetit të këtyre transaksioneve, interesave financiarë të përfshirë dhe për shkak të një pikëtakimi shumë të madh mes sektorit privat dhe sektorit publik. Për hir të së vërtetës, korrupsioni në prokurimin publik nuk është një sfidë dhe shqetësim ekskluzivisht lokal. Sondazhi “*World Economic Forum*” ka evidentuar se ryshfeti nga ndërmarrjet ndërkombëtare në vendet e OECD-së është më i shpeshtë në prokurimin publik se në sektorë të tjerë, si në tatime apo drejtësi. Gjithashtu, në vendet e OECD-së korrupsioni në prokurimin publik shton 10%-20% të kostove totale të kontratës, ndërsa në Bashkimin Europin prokurimi publik përfaqëson 14% të GDP-së së shteteve anëtare dhe 57% të rasteve të ryshfetit nga zyrtarët e huaj përfshijnë atë të dhënë për përfitimin e kontratave të prokurimit publik.

Në prokurimin publik korrupsioni manifestohet qoftë në formë të shprehur përmes dhënies së ryshfetit për të fituar kontratën, për të manipuluar shpërndarjen e buxhetit apo për manipulimin e kriterëve përzgjedhësve apo me shfaqje më të heshtura, të cilat përcaktojnë konkurrencën mes operatorëve ekonomikë në formën e marrëveshjeve për përcaktimin e ofertës. Është e pamohueshme që në mënyrë të vazhdueshme janë ndërmarrë reforma për ta adresuar korrupsionin

edhe në këtë sektor. Megjithatë, korrupsioni përfaqëson një fenomen evolutiv, ndaj kërkohet vigjilencë dhe përgatitje e strategjisë për ta parandaluar dhe për ta luftuar.

Hartimi i strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit përfaqëson një nga masat e ndërmarra në këtë drejtim, por puna që zhvillojnë ekspertët pranë komisionit të posaçëm parlamentar, karakterizohet nga një frymë më reformuese për ta adresuar në mënyrë më themelore korrupsionin sistemik. Ndërmarrja e reformave të njëpasnjëshme mund t'u ketë dhënë zgjidhje disa problematikave, duke forcuar sigurinë juridike, megjithatë mbeten ende problematika.

Unë po u referohem këtyre dy rasteve nga struktura, që është krijuar për zgjidhjen e ankesave në prokurimet publike lidhur me Komisionin e Prokurimit Publik. Pra, mbetet ende i paqartë roli dhe natyra që kanë vendimet e dy organeve, të Komisionit të Prokurimit Publik dhe të Gjykatës Administrative të Apelit, nëse kjo e fundit do të gjykojë si Gjykatë e Shkallës së Parë apo si Gjykatë e Apelit, duke u dhënë vendimeve të nxjerra prej saj atributet e titullit ekzekutiv.

Gjithashtu, ndonëse ky proces lejon ankimin e pjesëmarrësve, pra për të gjitha subjektet, për pikëzimin e tyre, nuk është përthithur tërësisht standardi i Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Europian, i cili ka përcaktuar se secili pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik mund të ankohet jo vetëm për pikëzimin e tij, por edhe të konkurrentëve të tjerë, duke zgjeruar mundësinë për rivlerësimin e të gjithë pjesëmarrësve në proces.

Në kuadër të punës së zhvilluar nga grupi i ekspertëve, është synuar që ndërhyrja për ta luftuar dhe për ta parandaluar korrupsionin të jetë gjithëpërfshirëse, duke adresuar jo vetëm sfidat në sektorin publik, që përfaqëson anën e kërkesës në fenomenin e korrupsionit, por edhe sektorin privat, praktikisht anën e ofertës. Ndaj janë propozuar masa për ta adresuar korrupsionin në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat, duke synuar që të dy sektorët të bëhen më rezistentë ndaj tundimit.

Gjithashtu, në fushën e prokurimeve është propozuar që përfitimi i fondeve publike nga operatorët ekonomikë të kushtëzohet nga zbatimi i programeve të posaçme antikorrupsion. Gjithashtu, është prezantuar edhe koncepti i “*business rating*” si kriter vlerësimi për përfitimin e fondeve. Nga ana tjetër, më duhet të theksoj se edhe sektorët e tjerë, të cilët janë ndjeshëm më të ekspozuar ndaj korrupsionit, nuk janë tërësisht një fenomen i lidhur vetëm me realitetin tonë, por raportet tregojnë që edhe në Bashkimin Europian sektorë të ngjashëm janë dhe mbeten më të ekspozuar ndaj korrupsionit, ndër to, përfshihen: shëndetësia, infrastruktura, ndërtimi, sektori financiar dhe ai bankar, doganat e të tjera. Pothuajse për të gjitha këto fusha emëruesi i përbashkët

është numri i lartë i përfitueseve të shërbimeve të tyre dhe ndërveprimi më i madh i sektorit publik me atë privat.

Pa dashur të zgjatem më tej për analizën, po ia kaloj fjalën profesoreshë Nada Dollanit për të ndarë gjetjet dhe fushat kryesore të ndërhyrjes për tatimet, doganat dhe sektorët e tjerë.

Fjala për ju.

Faleminderit!

Nada Dollani – Faleminderit!

Të nderuar të pranishëm,

Të nderuar deputetë dhe përfaqësues të institucioneve...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull.

Është një privilegj të jem sot para jush për të ndarë një analizë për sfidat dhe përpjekjet për ta adresuar korrupsionin në disa prej sektorëve më të rëndësishëm të administratës publike.

Lufta kundër korrupsionit përbën një prioritet të përhershëm në çdo shoqëri demokratike për të ndërtuar besimin e qytetarëve tek institucionet dhe për të krijuar kushtet për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm.

Sektorët që përballen me risk të lartë për korrupsionin, përfshijnë tatimet, doganat, shëndetësinë, arsimin, pronat, prokurimet publike, koncesionet dhe investimet strategjike. Në këtë prezantim unë do të fokusohem te sektorët e tatimeve dhe doganave, duke analizuar problematikat dhe duke ofruar disa masa konkrete për përmirësimin. Për sektorët e shëndetësisë dhe të arsimit që, sipas raportit të Komisionit European të vitit 2024 shfaqin problematika më të moderuara, do të bëj një trajtim të shkurtër. Ndërsa sfidat në sektorin e pronave janë adresuar në një tryezë tjetër.

Për sa i përket strategjisë për luftën kundër korrupsionit për të gjithë sektorët me rrezik të lartë, në sektorët me rrezik të lartë për korrupsionin kërkohet një qasje strategjike, që përfshin zhvillimin e vlerësimeve të synuara të rrezikut, të cilat duhet të identifikojnë pikat e dobëta dhe të mundësojnë hartimin e planeve të qarta të masave për zvogëlimin e korrupsionit. Gjithashtu, duhet rriten kapacitetet e administratës publike përmes trajnimeve të përqendruara në integritet dhe etikë, duke i përgatitur punonjësit për të përballur situata delikate dhe për të minimizuar mundësitë për abuzim.

Gjithashtu, një shtyllë e tretë, ku duhet të përqendrohet strategjia, është ndërgjegjësimi i qytetarëve që përfshin informimin e tyre për mekanizmat e raportimit të korrupsionit dhe

institucionet përgjegjëse. Ky është një hap i rëndësishëm për të fuqizuar qytetarët dhe për të ndërtuar një kulturë llogaridhënie dhe transparence. Këto tri elemente janë themelore për të ndërtuar një administratë më efikase dhe për të forcuar besimin e publikut tek institucionet shtetërore.

Sektorë të veçantë

Në sektorin e tatimeve, përsos arritjeve të rëndësishme në këtë fushë, nga raporti i Komisionit European për vitin 2024, evidentohen disa problematika kryesore në administratën tatimore. Për shembull, thjeshtimi i sistemit tatimor mbetet një domosdoshmëri për të nxitur përputhshmërinë dhe për të reduktuar mundësitë për mashtrim dhe evazion tatimor. Mungesa e burimeve njerëzore, me 164 vende vakante në qershor të vitit 2024, ndikon në efikasitetin e administratës tatimore dhe në mbështetjen e qytetarëve. Përdorimi i të dhënave të fiskalizimit dhe i të dhënave të palëve të treta mbetet i kufizuar, duke mos përmbushur plotësisht potencialin për monitorim të saktë dhe përputhshmëri. Kompleksiteti i ligjeve dhe ndryshimet e shpeshta krijojnë hapësira për shkelje të integritetit, ndërsa ndërgjegjësimi dhe transparenca mbeten të domosdoshme për të ruajtur besimin e publikut.

Nga auditimi i Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2022 përzgjidhja automatike e subjekteve për kontroll është një hap pozitiv, por procedurat manuale dhe mangësitë ligjore në zbatim paraqesin sfida të tjera.

Për sa i përket propozimit për masën, në raport me këto sfida dhe problematikat që shfaqen në sektorin e tatimeve, propozohet thjeshtimi dhe përmirësimi i kuadrit ligjor për të zvogëluar hapësirat për keqpërdorim dhe për të lehtësuar përmbushjen e detyrimeve tatimore; propozohet përdorimi më efektiv i të dhënave nga palët e treta për të identifikuar dhe për të parandaluar evazionin tatimor dhe përmirësimin i kontrolleve përmes një sistemi tërësisht automatik dhe transparent që eliminon ndërhyrjet manuale; propozohet rritja e burimeve njerëzore dhe trajnimi i stafit për të garantuar një administratë profesionale dhe me kapacitete të mjaftueshme; propozohet forcimi i mekanizmave për sinjalizuesit, duke garantuar mbrojtje dhe duke inkurajuar raportime, si dhe edukimi i qytetarëve për rëndësinë e përmbushjes së detyrimeve tatimore për të ndikuar në zhvillimin e vendit.

Në lidhje me situatën aktuale në dogana dhe për problematikat, së pari, kemi paraqitur arritjet që ka pasur. Në situatën aktuale në dogana kemi një sërë arritjesh. Për shembull, modernizmi dhe digjitalizimi; kemi sistemin e ri të kompjuterizuar të transitit; dritaren e vetme kombëtare; kemi menaxhimin e riskut; një luftë të gjerë kundër korrupsionit dhe arritje të tjera

institucionale, që kanë marrë vlerësime pozitive nga institucione të ndryshme ndërkombëtare për performancën e tyre. Megjithatë, përsëri mbeten disa problematika në sektorin e doganave.

Për sa u përket problematikave, është lufta kundër kontrabandës dhe korrupsionit, ku kërkohet forcimi i kapaciteteve të administratës dhe bashkëpunim ndërinstitucional.

Harmonizimi me legjislacionin e BE-së

Nevojiten përshtatje me aktet zbatuese të kodit doganor të unionit dhe me format e reja të deklarimit të vlerave monetare në kufi.

Për sa i përket menaxhimit të rrezikut, për importin dhe eksportin e mallrave duhen përmirësuar procedurat e thjeshtuara dhe akcizat.

Për sa u përket sistemeve të IT-së, janë planifikuar investime të mëdha, por është e nevojshme të rriten burimet njerëzore dhe kapacitetet. Duhet të sigurohet lidhja e ardhshme me mjedisin elektronik doganor të BE-së. Nga digjitalizimi i shërbimeve doganore aktualisht ofrohen 43 shërbime, që janë të aksesueshme *online* në *e-Albania*”, por nevojiten përmirësime të mëtejshme.

Për sa i përket bashkëpunimit ndërinstitucional, forcimi i bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve të ndryshme të angazhuara në kontrollin doganor dhe luftën kundër korrupsionit kërkohet që të zgjerohet dhe të përmirësohet.

Për sa u përket masave, të cilat janë propozuar apo që propozohen nga analiza e realizuar, janë: forcimi i kapaciteteve administrative dhe bashkëpunimit ndërinstitucional për t’i adresuar më mirë sfidat operacionale; harmonizimi me kuadrin ligjor të BE-së për të siguruar një përputhje me të plotë; avancimi i digjitalizimit për të thjeshtuar procedurat dhe për të rritur transparencën; rritja e burimeve njerëzore për të përballuar nevojat e reja dhe për të reduktuar hapësirat për shkelje, si dhe bashkëpunimi ndërinstitucional.

Ashtu siç e thashë, për sa i përket situatës në shëndetësi dhe në arsim, grupi i punës ka realizuar një analizë të hollësishme. Megjithatë, për shkak se në raportin e Komisionit Europian për vitin 2024 këta sektorë paraqiten më të moderuar dhe nuk janë përshkruar si sektorë me risk të lartë, pra ka pasur përmirësime në këta sektorë, ne do të ndalemi shkurtimisht dhe do të themi vetëm pak gjëra në raport me përmirësimet.

Në shëndetësi dhe në arsim zbatimi i mangët i legjislacionit dhe mekanizmave mbikëqyrës mbeten disa sfida kyçe. Në shëndetësi përfarimi i legjislacionit me *acquis*-në dhe forcimi i sistemit elektronik të informacionit shëndetësor janë hapa të domosdoshëm. Ndërsa në arsim transparenca

dhe llogaridhënia në rekrutim dhe promovim janë aspekte që kërkojnë përmirësime të menjëhershme.

Së fundi, mbeten ende disa çështje të hapura për diskutim, për shembull, si mund të përmirësojmë transparencën dhe llogaridhënien në sektorin tatimor dhe atë doganor; çfarë roli mund të luajë teknologjia në reduktimin e hapësirave për korrupsion dhe si mund t'i fuqizojmë sinjalizuesit dhe mekanizmat mbrojtës për ta.

Së fundi, dua të them që lufta kundër korrupsionit kërkon përkushtim, bashkëpunim dhe veprime të mirëkoordinuara. Masat e propozuara përbëjnë një bazë solide për të ndërtuar një administratë transparente, efikase dhe me integritet.

Faleminderit!

Jonida Rustemaj – Faleminderit, profesoreshe Dollani!

Tashmë fjala është për zonjën Eda Noçka, e cila do të ndajë disa nga gjetjet paraprake dhe fushat kryesore të ndërhyrjes në sferën e prokurimeve, koncesioneve, partneritetit publik-privat dhe investimeve strategjike.

Fjala për ju.

Eda Noçka – Të nderuar deputetë,

Të nderuar përfaqësues të institucioneve publike, organizatave të shoqërisë civile dhe biznese,

Të nderuar pjesëmarrës,

Në vijim të prezantimit që zonja Dollani bëri për disa nga sektorët me risk të lartë ndaj korrupsionit, raportet e Komisionit Europian identifikojnë edhe sektorë të tjerë si më të ndjeshëm ndaj këtyre fenomeneve, siç janë prokurimet publike, partneritetet publike-private dhe koncesionet.

Një tjetër sektor i përfshirë në analizën e sektorëve me risk të lartë janë edhe investimet strategjike, për shkak të ndikimit të tyre në interesin publik dhe duke qenë se përfshin edhe përdorimin e pasurive dhe të fondeve publike.

Në fushën e prokurimit publik, në përpjekje për të luftuar korrupsionin dhe për të përmirësuar transparencën, janë ndërmarrë një sërë masash dhe reformash të rëndësishme. Ligji i ri “Për prokurimet publike”, i miratuar në vitin 2020 dhe ndryshimet që i janë bërë këtij ligji në vitin 2024, sollën një sërë përmirësimesh në disa aspekte, siç janë rritja e transparencës, nxitja e konkurrencës, shmangia e konfliktit të interesit, lehtësimi i pjesëmarrjes së operatorëve

ekonomikë, shmangia e zvarritjes së procesit të prokurimit, për shkak të tejzgjatjes së procesit të ankimit administrativ, forcimi i kontrollit të Agjencisë së Prokurimit Publik. Gjithashtu, edhe plotësimi i kuadrit ligjor me të gjitha aktet nënligjore është një tjetër hap i rëndësishëm jo vetëm në drejtim të zbatimit efektiv të ligjit, por, gjithashtu, edhe në kuadër të harmonizimit me legjislacionin europian. Komisioni Europian vlerëson se sistemi elektronik i prokurimit publik ka rritur transparencën, ka rezultuar në akses më të lehtë, thjeshtim të proceduarve, kosto të ulëta dhe përmirësim të mbledhjes dhe monitorimit të të dhënave.

Po ashtu, edhe sistemi i ankesave është funksional dhe lehtësisht i aksesueshëm dhe, sipas raportit të vlerësimit më të fundit të publikuar të SIGMA-s, Shqipëria ka marrë vlerësimet maksimale në tre tregues të rëndësishëm, duke përfshirë cilësinë e kuadrit ligjor, kapacitetet institucionale dhe administrative dhe zhvillimin e procedurave të shqyrtimit. Megjithatë, pavarësisht progresit të rëndësishëm të arritur në fushën e prokurimit publik, ky sektor mbetet dhe identifikohet si një sektor me rrezik të lartë, për shkak të rolit të tij në menaxhimin e fondeve publike.

Pa dashur të ndalem më shumë në detajet e ndërhyrjeve të përgjithshme, pra të atyre ndërhyrjeve që zonja Dollani i shpjegoi si ndërhyrje të vlefshme për të gjithë sektorët me rrezik të lartë, do të doja të kaloja në propozimet konkrete për sektorin e prokurimeve publike. Siç e theksova, ligji i prokurimeve publike dhe ndryshimet në ligj të vitit 2024 sollën përmirësime të rëndësishme dhe Komisioni Europian ka vlerësuar që kuadri ligjor për prokurimin publik është kryesisht në përputhje me legjislacionin europian. Megjithatë, vlerësohet nevoja e harmonizimit të mëtejshëm të kuadrit ligjor për prokurimin publik me direktivat e BE-së, me qëllim përputhjen me standardet europiane dhe për të përmirësuar efikasitetin, transparencën dhe sistemin e prokurimit publik.

Në nenin 8 të ligjit “Për prokurimin publik” parashikohen rastet specifike kur dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen, duke përfshirë edhe rastet kur procedurat janë të parashikuara në marrëveshje ndërkombëtare apo edhe në rregullat organizatave ndërkombëtare. Raportet kanë evidentuar raste kur marrëveshjet ndërqeveritare apo parashikimet ligjore, përveç përjashtimit nga rregullat e prokurimit publik, kanë parashikuar edhe përjashtime nga procedurat konkurruese. Në këtë aspekt, për të siguruar një sistem prokurimi transparent, efektiv dhe të drejtë, është e rëndësishme që të gjitha instrumentet ligjore dhe financiare të përdorura në këtë fushë, duke përfshirë edhe marrëveshjet ndërqeveritare me vendet të treta për zbatimin e projekteve të

përbashkëta, të jenë në përputhje me parimet themelore të transparencës, konkurrencës dhe trajtimit të barabartë, njëkohësisht edhe në përputhje me *acquis*-në e BE-së dhe Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit.

Në kuadër të zhvillimit të një sistemi efektiv për parandalimin e korrupsionit në prokurimet publike, përpjekjet duhet të fokusohen në forcimin e mëtejshëm të funksionimit të përgjithshëm të sistemit për të rritur konkurrencën, pajtueshmërinë dhe profesionalizmin. Në kuadër të rritjes së konkurrencës, nxitja dhe përmirësimi i përdorimit të kriterit të ofertës ekonomikisht më të favorshme, bazuar në kosto, është i rëndësishëm për të mundësuar vendimmarrje të drejtë dhe të bazuar në një analizë të balancuar cilësi-kosto. Në përputhje edhe me parimet e OECD-së, ky kriter promovon integritetin, llogaridhënien në prokurimet publike, duke nxitur konkurrencën e bazuar jo vetëm në çmimin më të ulët, por edhe në cilësinë dhe vlerat afatgjata. Pjesëmarrja e ulët e operatorëve ekonomikë vendas dhe të huaj në proceset e prokurimit me 23% të procedurave të përfunduara vetëm me një ofertë, tregon nevojën për të rritur konkurrencën dhe për të inkurajuar pjesëmarrjen e operatorëve. Gjithashtu, kuadri ligjor për prokurimin publik vlerësohet si gjithëpërfshirës dhe i detajuar, njëkohësisht shumë urdhërues, duke kufizuar fleksibilitetin e autoriteteve kontraktore. Dispozitat të tilla, siç janë sigurimi i ofertës 2% të vlerës së kontratës, përveç prokurimeve me vlerë të vogël mund të kufizojnë, gjithashtu, aksesin në treg.

Praktikat më të mira vlerësojnë se kuadri rregullator dhe sistemet e prokurimit nuk duhet të jenë të ndërlikuara, të kushtueshme, të ngadalshme, pasi ato ndikojnë negativisht në pjesëmarrje.

Kërkesat për garanci monetare, kërkesat për kualifikim, që nuk janë në proporcion me madhësinë e kontratës, procedurat e komplikuar dhe kostot e larta të përgatitjes të ofertave përbëjnë, gjithashtu, pengesa për aksesin në treg, ulin konkurrencën dhe rritin mundësitë për abuzim.

Profesionalizmi në prokurimin publik mbetet një nga objektivat dhe sfidat kryesore, duke qenë se rritja e kapaciteteve ndikon drejtpërdrejt në eficiencën e procedurave dhe në shmangien e praktikave korruptive.

Autoritetet kontraktore vazhdojnë të përballen me sfida të lidhura me mungesën e kapaciteteve për menaxhimin efektiv të prokurimeve dhe në këtë drejtim forcimi i mbështetjes nga Agjencia e Prokurimit Publik për autoritetet kontraktore dhe zbatimin e masave të parashikuara për trajnimin dhe certifikimin e punonjësve janë hapa të domosdoshëm për të garantuar standarde të larta profesionale që përfshijnë njohuritë, aftësitë dhe integritetin.

Gjithashtu, përmirësimi i cilësisë së dokumenteve mbështetëse dhe udhëzimeve është thelbësor për të siguruar pajtueshmërinë me rregullat e prokurimit publik. Duhet të forcohen dhe është thelbësore të forcohen sistemet e kontrollit të brendshëm si linja e parë e mbrojtjes, me fokus të veçantë te mekanizmat për sundimin dhe raportimin e parregullsive brenda autoriteteve kontraktore. Ky proces kërkon identifikimin e rreziqeve për integritetin, bazuar në vlerësimet e plota, ashtu siç u theksua, në ndërhyrjet e përgjithshme dhe në zbatimin e rregullt të kontrolleve dhe auditimeve të brendshme.

Gjithashtu, Agjencia e Prokurimit Publik duhet të vazhdojë të luajë një rol proaktiv në verifikimin e ligjshmërisë së procedurave dhe monitorimin e kontratave, ndërsa publikimi i rezultateve të kontrolleve të brendshme mbetet një element i rëndësishëm për të rritur transparencën dhe llogaridhënien.

Zhvillimi i teknologjisë së informacionit dhe përfshirja e inteligjencës artificiale në sistemin elektronik të prokurimit publik përbën një hap të rëndësishëm në drejtim të parandalimit të korrupsionit. Përmirësime të tilla, siç janë: automatizimi i përlogaritjes së vlerës limit, hartimi i specifikimeve teknike përmes sistemit elektronik të prokurimit publik dhe ndërveprimi me sistemet e tjera kombëtare janë zhvillime që shkojnë në drejtim edhe të luftës kundër korrupsionit. Edhe funksionalitetet e avancuara, si sinjalizimet e flamurit të kuq, do të mundësojnë identifikimin dhe administrimin e shpejtë të parregullsive.

Megjithatë, suksesin e këtyre zhvillimeve e garanton përdorimi i të dhënave të sakta dhe të plota, të cilat janë thelbësore për një sistem të besueshëm dhe efikas.

Komisioni European identifikon korrupsionin, informalitetin, problemet me titujt e pronësisë, procedurat jotransparente në prokurimet publike, veçanërisht partneritetet publike-private, si sfidat kryesore që dëmtojnë klimën e biznesit dhe në këtë drejtim është e nevojshme të merren masa të mëtejshme për të përmirësuar transparencën në prokurimet publike, koncesionet dhe partneritetet publike-private duke u fokusuar në krijimin e një sistemi më të hapur dhe më të besueshëm.

Për sa i përket ndjekjes penale dhe gjyimit, është e nevojshme të vazhdojnë përpjekjet për ndërtimin e një historiku *track record* për ndjekjen dhe gjykimin e rasteve të korrupsionit në prokurimet publike, duke marrë në konsideratë edhe rritjen e vazhdueshme të këtyre çështjeve dhe hetimeve në këtë drejtim.

Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitutional midis Agjencisë së Prokurimit Publik, institucioneve të hetimit financiar dhe prokurorisë duhet, gjithashtu, të konsolidohet përmes zbatimit të plotë të marrëveshjeve ekzistuese, çka do të përshpejtojë edhe hetimin e rasteve.

Përfshirja e ekspertizës së specializuar në fushën e prokurimeve publike, kryesisht sa u përket specifikimeve teknike dhe metodave të avancuara të prokurimit, do të lehtësojë identifikimin dhe trajtimin e rasteve komplekse të prokurimit.

Ligji “Për prokurimin publik” garanton të drejtën e ankimit për operatorët ekonomikë pa asnjë diskriminim dhe pavarësisht nga lloji i procedurës.

Gjithashtu, procesi i ankimit administrativ është rikonceptuar për të lehtësuar pjesëmarrjen e palëve dhe për të shmangur zvarritjet në procedurat e prokurimit. Në vitin 2023 pati një reduktim të ndjeshëm të përqindjes së ankesave të shqyrtuara jashtë afatit, me 9,4%, megjithatë, konsiderohet e nevojshme që kapaciteti i Komisionit të Prokurimit Publik për të trajtuar numrin e lartë të ankesave duhet të përmirësohet më tej, duke siguruar që koha e shqyrtimit të tyre të jetë plotësisht në përputhje me afatet ligjore të përcaktuara.

Raportet identifikojnë sfida që lidhen me pavarësinë e Komisionit të Prokurimit Publik, pasi pesë anëtarët e këtij organi emërohen nga Kuvendi i Shqipërisë me propozim të Këshillit të Ministrave dhe një nga ndërhyrjet e rekomanduara shkon në drejtim të procesit të emërimit të anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik përmes një mekanizmi të pavarur për përzgjedhjen e kandidatëve, si një hap që duhet të mbahet në konsideratë për të garantuar vendimmarrje të paanshme dhe transparente.

Në fushën e koncesioneve dhe partneriteteve publike-private, përveç ndërhyrjeve të përgjithshme për të gjithë sektorët me risk dhe ndërhyrjes sa i përket rritjes së transparencës, një nga ndërhyrjet e rekomanduara shkon në drejtim të përmirësimit të kuadrit ligjor, kjo për arsye dhe me qëllim harmonizimin e mëtejshëm me legjislacionin europian dhe jo vetëm, duke përfshirë edhe disa aspekte të rëndësishme, siç janë propozimet e pakërkuara, duke ofruar procedura të qarta dhe transparente për trajtimin e tyre; përcaktimi në mënyrë të detajuar i ndarjes së rreziqeve operative nëpërmjet sektorit publik dhe privat, përcaktimi i fushës dhe zbatimit të ligjit në përcaktimin e llojeve dhe shërbimeve që përfshihen në koncesionet dhe partneritetet publike-private, si dhe dispozita që lidhen me transparencën, konkurrencën dhe forcimin e menaxhimit dhe performancës së kompanive.

Aktualisht, për t'i adresuar këto mangësi dhe për ta përafruar më tej legjislacionin shqiptar në fushën e koncesioneve dhe partneriteteve publike-private, është ndërmarrë edhe iniciativa për hartimin dhe miratimin e një ligji të ri.

Në të njëjtën mënyrë, problematikat lidhur me forcimin e kapaciteteve teknike për të hartuar dhe vlerësuar partneritetet publike-private duhet të zhvillohen, gjithashtu, më tej, duke adresuar pikërisht dobësitë ekzistuese dhe duke rritur efikasitetin në këtë sektor.

Fushat e trajtuara në analizën e sektorëve me risk të lartë janë investimet strategjike. Raportet identifikojnë që ligji “Për investimet strategjike”, i miratuar në vitin 2015, me synim për të promovuar investimet e brendshme dhe të huaja në sektorë strategjikë, nuk arriti të tërheqë investime të huaja të rëndësishme megjithëse afati i ligjit është zgjatur disa herë.

Shumica e projekteve të miratuara janë përqendruar në sektorin e turizmit dhe dominohen nga investitorët vendas.

Regjistri i investimeve strategjike, si një instrument kyç për identifikimin, monitorimin dhe garantimin e transparencës, nuk është i aksesueshëm publikisht.

Në perspektivën e ndryshimeve dhe përmirësimeve të ardhshme në ligjin “Për investimet strategjike”, ku afati i projekteve përfundon më 31 dhjetor të këtij viti (megjithatë, një propozim i është paraqitur Kuvendit për shtyrjen e këtij afati deri më 31 dhjetor të vitit 2027), pra në perspektivën e këtyre ndryshimeve, përveç shtyrjes së afatit, është e rëndësishme që ligji të përcaktojë edhe disa aspekte të tjera të rëndësishme, siç është forcimi i transparencës në çdo fazë të procesit, përcaktimi i kriterëve të qarta për përzgjedhjen e investitorëve, vendosja e procedurave të detajuara për vlerësimin e projekteve, përfshirja e mekanizmave për monitorimin dhe raportimin periodik të investimeve strategjike, rregullave për shmangien e konfliktit të interesit dhe forcimin e integritetit në vendimmarrje.

Është i rëndësishëm, gjithashtu, ashtu siç e parashikon edhe vetë ligji “Për investimet strategjike”, publikimi i regjistrit të investimeve strategjike, çka do të mundësojë edhe monitorimin publik.

Po ashtu, vlerësohen të nevojshme edhe monitorimi dhe vlerësimi periodik i investimeve strategjike, duke përcaktuar indikatorë të qartë për matjen e performancës dhe ndikimit të këtyre investimeve në ekonomi, mjedis dhe shoqëri.

Zhvillimi i politikave të qarta dhe të qëndrueshme që krijojnë një ambient më të favorshëm për investitorët e huaj, duke siguruar transparencë në proceset e investimeve, është një tjetër nga ndërhyrjet e propozuara.

Këto ishin, në mënyrë të përmbledhur, disa nga ndërhyrjet e rekomanduara në këta sektorë me risk të lartë ndaj korrupsionit.

Mbetem e hapur për çdo diskutim të mëtejshëm për plotësimin dhe përmirësimin e tyre.

Faleminderit!

Jonida Rustemaj – Faleminderit, zonja Noçka, për ndarjen e gjetjeve dhe fushave kryesore të ndërhyrjes, që, në fakt, të gjitha janë reflektuar në draftin e analizës, ku është bërë një analizë më e thellë, për hir të së vërtetës, dhe më gjithëpërfshirëse për të gjitha çështjet që ju prekën në fjalën tuaj!

Tashmë ftoj pjesëmarrësit për të ndarë perspektivën, këndvështrimin e tyre mbi gjetjet e prezantuara dhe fushat kryesore të ndërhyrjes, por do t'ju lutesha që për efekt kohe fjalën ta sintetizoni në jo më shumë se 3 minuta, në mënyrë që të gjithë të kenë mundësi të shprehen.

Faleminderit!

Po, zoti Jaka, fjala për ju.

Nikolin Jaka – Në fakt, unë do të preferoja të flisja i fundit, se mund ta kaloj afatin 3-minutësh, por, gjithsesi, kërkoj mirëkuptimin tuaj.

Në radhë të parë, do të doja t'i vlerësoja edhe gjetjet, edhe propozimet, me një sugjerim të vogël: paraprakisht të mund të na i dërgoni në institucion, në mënyrë që ne t'i sqarojmë me anëtarët tanë dhe të vijmë këtu edhe me propozime konkrete. Jam i sigurt që këto do t'i kemi gjatë procesit, sepse është një proces i ngritur që nuk ndalon, me sa shoh unë.

Do të doja të ndalesha pak tek tatimet dhe doganat.

Dhoma e Tregtisë ka pasur një marrëdhënie permanente me institucionet qendrore që kanë lidhje me sipërmarrjen private dhe që e cekin komunikimin e tyre.

Do të doja të vlerësoja dhe të falënderoja realisht jo vetëm performancën, por edhe raportin e krijuar me sipërmarrjen private të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, e cila e ka shtruar në një rrugë bashkëpunimin me sipërmarrjen dhe me zgjidhjen e problematikave që sipërmarrja ka.

Ne kemi zhvilluar mbi tri takime dhe tri mbledhje të mëdha me përfaqësues të doganave, ku është vënë re sa efikase dhe rezultative janë këto takime, ku sipërmarrja komunikon drejtpërdrejt me të gjitha sportelet dhe me të gjithë përfaqësuesit e doganës, por merr edhe

orientimin e duhur, sepse jam i bindur që jo të gjithë e dinë çfarë të drejtash përfitojnë nga ligji. Dhe ky është një përfitim i drejtpërdrejtë që është marrë në tryezat tona dhe që Dhoma e ka transmetuar.

Jam i bindur që edhe me tatimet do ta kemi një kombinim të tillë, edhe me Autoritetin e Konkurrencës apo edhe institucione të tjera, të cilat kanë të bëjnë drejtpërdrejt me pjesën e sipërmarrjes.

A ka problematika? Pa diskutim që ka problematika dhe ju i cekët në pjesën tuaj.

Informaliteti është një nga plagët më të rënda në ekonominë e vendit, por jo vetëm, sepse është një plagë e rëndë për sipërmarrjen private.

Institucionet ligjzbatuese janë të orientuara për të kontrolluar gjithmonë subjektet e regjistruara dhe nuk janë në fokusin e tyre, të paktën të përditshmërisë, për të gjetur mekanizmat e informalitetit, dhe ato ngelin edhe të pakontrolluara, sepse në momentin kur një subjekt e ka të regjistruar adresën dhe selinë e tij, normalisht tatimet, në mënyrë elektronike, bëjnë ose njoftimin, ose kontrollin, ndërkohë që informaliteti na ngelet jashtë loje. Ndaj unë mendoj se ne duhet të hartojmë një strategji dhe mund ta pagëzojmë si një “reformë të rëndësishme në ekonominë e vendit”, sepse, në qoftë se ne ulim shifrat e formalizimit, nuk bëjmë gjë tjetër veçse kthejmë optimizmin të sipërmarrja e ndershme dhe, nga ana tjetër, mbushim buxhetin e shtetit me ato të ardhura të munguara që shkojnë nga informalët.

Ndërsa lidhur me prokurimet, unë mendoj se ka një zhvillim pozitiv. Kjo është e padiskutueshme. Komunikimi *online* i prokurimit publik ka sjellë një qasje pozitive të sipërmarrja private. Normalisht, ngelin problematika të ndryshme dhe si çdo vend, edhe Shqipëria, karakterizohet nga probleme të ndryshme qoftë të konkurrencës, qoftë të marrëveshjeve të heshtura për shumë e shumë gjëra e fenomene të tjera të cilat ndodhin rëndom.

Ajo për çfarë unë do të doja të ndalesha pak të prokurimet është, të paktën, problematika që u cek edhe në fillim të moderimit të tryezës, që nuk kuptohet roli i Komisionit të Prokurimit Publik me Gjykatën Administrative të Apelit.

Unë mendoj që nuk duan ta kuptojnë, jo se nuk kuptohet, sepse Gjykata Administrative e Apelit e ka shprehimisht të qartë që vendimet e Gjykatës së Apelit janë të formës së prerë dhe ekzekutohen, ndërkohë që Komisioni i Prokurimit Publik, në mënyrë permanente dhe të përgjithshme, operon në mënyrë të pavarur dhe pa e lidhur aktivitetin e tij me vendimet e Gjykatës së Apelit.

Pra, krijon një pavarësi dhe një anomali ligjore, duke e transmetuar që, jo, Gjykata e Apelit nuk është, e trajton si fazë të parë. Arsyeja pse është futur Gjykata Administrative e Apelit në shqyrtimin e ankesave është bërë për të thjeshtuar dhe shkurtuar procedurën, ndërkohë edhe për t'i dhënë një autoritet Komisionit të Prokurimit Publik që ky autoritet, duke qenë edhe një organ i zgjedhur nga Kuvendi, të ketë autoritetin e Gjykatës së Shkallës së Parë, por, për hir të së vërtetës, Komisioni i Prokurimit Publik nuk e respekton këtë gjë.

Ndërkohë, problemi tjetër me prokurimet publike në përgjithësi është mungesa e Agjencisë së Monitorimit të Kontratave të Shërbimeve dhe Ndërtimit.

Çfarë ndodh? Megjithëse ligji e përcakton qartë që merret oferta ekonomike më e favorshme, duke bërë një analizë të kostos dhe të cilësisë, në Shqipëri 99% e prokurimeve publike orientohet tek oferta më e ulët ekonomike, që është dëmi më i madh që i bëhet ekonomisë së vendit dhe sipërmarrjes në tërësi, sepse kemi subjekte që futen me 50% me ofertë dhe, pasi futen me 50%, e lënë objektin dhe shërbimin e papërfunduar. Kjo ka 34 vjet që shkon në këtë vazhdë dhe agjencitë e monitorimit janë pothuajse inekzistente. Është më se normale që një subjekt që futet me 50% dhe nuk ka asnjë lloj përgjegjësie tjetër, qoftë të integritetit apo qoftë të performancës së kompanisë së tij, mjaftohet me atë 50%, mjafton të mos bëjë punën dhe të mbarojë, ta quajë me sukses atë kontratë që realizon, pra agjencitë e monitorimit qoftë në prokurimet publike, qoftë në partneritetet publike-private, qoftë edhe në koncesionet apo edhe në ofertat e pakërkuara. Në qoftë se ne nuk i monitorojmë këto procedura, atëherë i bie që ne nuk kemi bërë asgjë dhe realisht dëmi që i shkaktohet ekonomisë është jashtëzakonisht i madh, sepse ka raste, dhe nuk dua t'i përmend me raste, që për të njëjtin objekt bëhet tenderi në 10 vjet katër herë dhe prapëseprapë objekti ngel i pambaruar apo joeficient për qytetarët.

Problem tjetër për prokurimin publik, sidomos në sektorin e infrastrukturës, është standardi. Kur ne duhet të bëjmë një korridor, duhet të marrim masa se ku duhet të kalojnë qytetarët me automjetet e tyre dhe nuk mundet që automjetet e qytetarëve të bëjnë rolin e rullit për të shtypur rrugët sipas fazave që ato bëjnë. Në mënyrë kategorike, kjo nuk ndodh në asnjë vend të botës.

Edhe në Afrikë po të shkosh, korridoret kanë strategjitë e tyre, zhvillimin dhe standardin e tyre. Nuk mundemi ne që me makinat tona ta shkelim rrugën derisa ajo të asfaltohet, por përcaktohen korridore dhe akseset për kalimin e udhëtarëve, pastaj vazhdohet me korridore.

Pra, duhet të jemi shumë të kujdesshëm me standardet, sepse humbja e jetës së qytetarëve në Shqipëri nuk vlerësohet dhe nuk ka kosto. Kjo është arsyeja që edhe standardin e kemi në këtë lloj niveli.

Këto kisha paraprakisht, por do ta vlerësoja shumë që ta kishim materialin paraprakisht, në mënyrë që ne të kemi përgjigje.

Ndërkohë, shfrytëzoj rastin të bëj edhe një kërkesë për komisionin e drejtuar nga zoti Xhafaj: do të donim që herën tjetër të kemi edhe problematikën e moskthimit të përgjigjeve nga institucionet qendrore dhe lokale të kërkesave të sipërmarrjes private, kur kalojnë afatet 15-ditore, 1-mujore apo edhe 3-mujore, 4-mujore.

Faleminderit!

Jonida Rustemaj – Faleminderit, zoti Jaka, për konstatimet tuaja dhe këndvështrimin mbi problematikat që ne trajtuam!

Një kujtesë të vogël: në fakt, të gjitha dokumentet, përmbledhja ekzekutive, ku përfshihen të gjitha çështjet që u ndanë këtu me ju, janë publike në faqen e komisionit të posaçëm parlamentar. Mund t'i konsultoni edhe pas këtij momenti në çdo rast.

Faleminderit!

Fjala për ju.

Ilir Binaj – Atëherë, do të doja edhe unë të ndaja disa mendime.

Së pari, i falënderoj ekspertët lidhur me gjetjet dhe sugjerimet për korrupsionin në administratën tatimore!

Patjetër për këtë problem mund dhe duhet të bëhet më shumë, por besoj se për ta ulur korrupsionin duhen marrë në konsideratë tre faktorë: mundësia për të bërë korrupsion, presioni financiar i nëpunësve të administratës tatimore dhe arsyetimi i korrupsionit.

Në dhjetë vjetët e fundit janë ndërmarrë shumë nisma për të ulur mundësinë për të bërë korrupsion, duke digjitalizuar pothuajse të gjitha shërbimet tatimore dhe duke ulur kontaktin fizik me tatimpaguesit. Shërbimet virtuale e kanë zvogëluar mundësinë e korrupsionit, duke e reduktuar atë përgjithësisht vetëm gjatë kontrolleve tatimore.

Në lidhje me kontrollet tatimore në vend, administrata tatimore është përpjekur ta ulë numrin e tyre duke kaluar me kontrollet nga zyra, por niveli i lartë i informalitetit e bën këtë pothuajse të pamundur dhe jemi të detyruar të bëjmë më shumë kontrolle në terren për ta adresuar këtë problem kritik, sidomos lidhur me pagat.

Tashmë ne kemi filluar aksione informaliteti më shumë për pensionet dhe deri tani nuk kemi marrë ankesa nga tatimpaguesit për raste korruptive.

Lusim qytetarët të raportojnë çdo rast korruptiv që evidentohet gjatë kontrolleve tona. Strukturat tona antikorrupsion janë aktive në këtë aksion duke intervistuar tatimpaguesit pas kontrollit për sjelljen e inspektorëve tanë.

Presioni financiar lidhet me gjendjen financiare të çdo nëpunësi të administratës tatimore. Duke konsideruar kostot e jetesës, presioni financiar mbetet i lartë, me gjithë rritjen domethënëse të pagave gjatë këtij viti. Besoj se pa adresuar plotësisht problemet financiare të nëpunësve civilë, risku ndaj akteve korruptive do të mbetet i lartë dhe për të adresuar këtë risk do të duhet të ushtrohen më shumë investigime të brendshme nga strukturat tona monitoruese.

Arsyetimi i korrupsionit

Faktori i fundit që duhet konsideruar është aftësia e nëpunësve të tatimeve për të racionalizuar sjelljen korruptive. Aftësia për të arsyetuar korrupsionin përfshin kulturën shoqërore, sjelljen, karakterin dhe vlerat etike. Kultura është *software* i grupit dhe nëse grupi shoqëror e toleron këtë sjellje, gjasat janë që aktet korruptive nuk do të raportohen, bile ata që nuk i bëjnë këto akte shpesh konsiderohen nën zë si budallenj.

Për të adresuar këtë problem, administrata tatimore ka filluar rekrutimet nga studentët e ekselencës, si një përpjekje për të rinovuar qasjen dhe kulturën e nëpunësve tanë. Si pjesë e kulturës së integritetit, shumë i rëndësishëm mbetet edhe toni i drejtuesve të administratës tatimore për ta adresuar këtë fenomen. Pa tonin e duhur në majë, çdo përpjekje do të kishte rezultate jodomethënëse. Për ta adresuar racionalizimin e sjelljes korruptive, administrata tatimore ka hartuar plane për të përmirësuar integritetin e nëpunësve të saj nëpërmjet trajnimeve dhe investigimit të çdo rasti që paraqitet për korrupsion, por duhet theksuar se korrupsioni në sektorin e tatimeve ka një lidhje të fortë me informalitetin, duke krijuar një rreth vicioz midis tyre. Kjo lidhje e bën të vështirë investigimin e strukturave tona antikorrupsion, të cilat marrin një numër minimal rastesh të kësaj natyre nga tatimpaguesit, që janë edhe të dëmtuarit e parë nga këto akte.

Gjithashtu, shumë e rëndësishme për luftën kundër korrupsionit është sensibilizimi i vazhdueshëm i të gjithë tatimpaguesve dhe punonjësve të administratës tatimore. Administrata tatimore do të organizojë gjatë vitit 2025 sondazhe me tatimpagues për të matur perceptimin e opinionit publik ndaj saj. Ne jemi të vetëdijshëm se reputacioni i administratës tatimore varet nga sjellja me integritet e çdo nëpunësi.

Në këtë kuadër, shtylla e dytë e strategjisë afatmesme të të ardhurave ka të bëjë me miradministrimin fiskal. Nga shtatë prioritete të përcaktuara, dy prej tyre lidhen me reduktimin e kostos së përmbushjes, rritjen e sigurtisë tatimore dhe të besimit ndaj administratës, si dhe me përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të afuara nga administrata tatimore nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve institucionale.

Secila prej këtyre masave ka të përfshira aktivitete specifike, që kanë të bëjnë me lehtësinë e përmbushjes tatimore, rritjen e cilësisë së shërbimit, digjitalizimin e mëtejshëm të proceseve të shërbimit, rritjen e integritetit dhe aftësisë së punonjësve të administratës tatimore. Këto masa janë përfshirë edhe në objektivat kryesore në planin strategjik të administratës tatimore për periudhën 2024-2028, i cili tashmë është publik në *website*-n tonë.

Së fundi, administrata tatimore është e hapur dhe mirëpret çdo rekomandim për ta adresuar këtë fenomen.

Faleminderit!

Jonida Rustemaj - Faleminderit për fjalën tuaj, zoti Binaj!

Ilir Binaj – Më falni, që fola më shumë se 3 minuta!

Jonida Rustemaj - Nuk ka gjë, se brenda arsyes e kemi edhe një kohë ekstra për 3 minutëshin.

Fjala për ju, zonja Ministre.

Delina Ibrahimaj - Përshëndetje të gjithëve!

Në radhë të parë dua të komplementoj ekspertët për të gjithë analizën e thelluar që i kanë bërë sektorit privat dhe risqeve të korrupsionit në sektorin privat. Gjithashtu, gjej rastin të falënderoj të gjithë ekipin e komisionit, i cili ka identifikuar të gjitha ato pika kyçe që kanë nevojë për një vëmendje më të madhe. Besoj se në tryezat që kam marrë pjesë janë adresuar një pjesë e madhe e elementeve që kanë nevojë për monitorim.

Në fakt, doja ta merrja pak më vonë fjalën, pasi të kisha dëgjuar më shumë përfaqësues të sektorit privat dhe elemente që sektori privat, organizatat e shoqërisë civile apo institucione të tjera do të donin të diskutonin në veçanti mbi analizën që ju i keni bërë, që, siç e thashë, është për t'u komplementuar, megjithatë do të them dy-tri fjalë shumë shkurt.

Edhe gjatë leximit që i bëra analizës vura re se në të gjithë sektorët me risk të lartë, si tatime, dogana, prokurime, koncesione, partneritete publike-private apo edhe investime strategjike, janë katër elemente kyçe, të cilat ritheksohen në vazhdimësi: e para është transparenca,

e dyta është thjeshtësia apo ndryshimet ligjore, pra elemente që lidhen me ligjin, e treta është profesionalizmi i administratës publike dhe e katërta është digjitalizimi i procedurave.

Unë besoj se ndër vite, ne, si përfaqësues të institucioneve, dhe nuk flas vetëm në kapelën që kam sot, por edhe në kapelën që kam pasur edhe në të shkuarën, jemi munduar t'u dedikohemi dhe të përqendrohemi në të gjithë këta sektorë dhe në përmirësimin e këtyre elementeve, megjithatë ka ende sfida, jetojmë të gjithë këtu dhe e dimë që korrupsioni është një dukuri. Pavarësisht se janë bërë shumë investime në digjitalizim, pavarësisht se në sektorë të caktuar, si tatimet dhe doganat, por edhe në sektorë të tjerë, ka institucione specifike që merren me aftësimin e stafit apo janë ngritur mekanizma të bilbilfryrësve, sinjalizuesve, përsëri kemi shfaqje të korrupsionit.

Unë besoj fort që ky lloj dialogu që vë në tryezë edhe ekspertë, edhe përfaqësues të sektorit privat, që kanë interesin parësor në një ekonomi të drejtë dhe në një ekonomi ku konkurrenca e zhdrejtë luftohet, por edhe institucionet publike dhe organizatat e shoqërisë civile, që, për hir të së vërtetës, nuk janë shumë aktive në debatin e sektorit privat, por që duhet të jenë, është mekanizmi i duhur për të kuptuar se çfarë elementësh duhet të përfshihen në planet e veprimit që komisioni do të nxjerrë në të ardhmen. Ndaj, dua të ftoj të gjithë përfaqësuesit, jo vetëm të institucioneve publike, të shprehin mendimet e tyre lirshëm, pasi për ne është shumë e rëndësishme, sepse, përveç dokumenteve strategjike apo dokumenteve që ne kemi punuar me Bashkimin Europian me qëllim adresimin e këtyre katër elementeve të rëndësishme, mbase ka eksperiencë praktike, e cila na shërben për të pasur plane veprimi, në mënyrë që, qoftë transparenca, qoftë thjeshtësia, qoftë profesionalizmi, qoftë edhe zhvillimi i digjitalizimit, të shkojnë në drejtimin e duhur dhe ne të gjithë së bashku të luftojmë këto dukuri, të cilat dëmtojnë qoftë shtetbërjen, qoftë ekonominë tonë.

Faleminderit!

Jonida Rustemaj – Faleminderit, zonja Ministre, për optikën tuaj për mënyrën se si duhet të ecim në drejtim të adresimit të këtij fenomeni!

Po, fjala për ju.

Lavdosha Ferruni – Faleminderit për ftesën! E vlerësoj shumë pjesëmarrjen në këtë takim për arsye se shoqëria civile ka kontributin e vet në luftën ndaj korrupsionit.

Sot dua të theksoj (këtu u përmend pak ose u përmend vetëm një herë) një fjalë: parandalimi i korrupsionit. Madje, edhe parandalimi u pa në aspektin e prokurimeve. Në fakt, kjo nuk është ajo, por është nga mesi i alfabetit të prokurimeve, sepse më përpara është vendimmarrja dhe më

përpara vendimmarrjes është strategjia. Ju përmendët pak edhe strategjinë si sektor me risk të lartë, si dhe investimet strategjike, ku përmendët zgjedhjen e investitorit, konfliktet, monitorimet, por ajo që mungon është parandalimi për lloje investimesh, strategjike dhe jostrategjike, që kanë të bëjnë me natyrën. Pra, bie fjala, një biznes mund të jetë fitimprurës në mes të pyllit, pret një pyll dhe fiton shumë. Edhe pse ka fituar shumë, edhe pse ka bërë tenderat në rregull e të gjitha gjërat, ky është korrupsion për arsye se ka bërë një dëm të madh në natyrë.

Në këtë aspekt, nuk pashë që të flitet për këtë gjë dhe duhet folur shumë më tepër për këtë gjë, për parandalimin e korrupsionit. Për parandalimin kemi një instrument të fuqishëm, tek i cili më duket se kemi bërë hapa pas, që është konsultimi me publikun. Pra është publiku, janë qytetarët e zakonshëm që mund ta luftojnë korrupsionin. Nuk e lufton vetëm administrata dhe ne që jemi këtu korrupsionin, por e luftojnë qytetarët në radhë të parë me mendimin e tyre, me oponencën që mund të bëjnë, e kështu me radhë.

Për këtë ka edhe një ligj, një konventë, që është Konventa e Aarhus-it, që, ndryshe nga shumë konventa të tjera, në thelbin e vet ka informacionin e publikut dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje. Kjo duhet bërë sipas ligjit shqiptar që në konceptimin e një projekti të caktuar. Pra, konceptohet një projekt dhe bëhen diskutime mbi këtë projekt.

Për të mos e zgjatur, do ta mbyll me një shembull konkret të kohëve të fundit. Është bërë një marrëveshje në Azerbajxhan për gazifikimin e Shqipërisë. Tani, mund të më thotë dikush nëse është bërë ndonjë diskutim që duhet bërë apo jo gazifikimi i Shqipërisë, që ka një impakt 30-vjeçar dhe, për mendimin tim, një risk të madh potencial të korrupsionit?

Faleminderit!

Jonida Rustemaj - Faleminderit për konstatimet tuaja, zoti Ferruni!

Vetëm për të dhënë një kontekst, duke qenë se ne hymë drejt e në temë, e cila lidhet me prokurimet publike, koncesionet, partneritetin publik-privat, në fakt, këto gjetje janë pjesë e një studimi pak më të gjerë, që në fokus ka pasur, për hir të së vërtetës, parandalimin e korrupsionit në sektorin publik dhe atë privat. Ndaj, një pjesë e mirë e masave që janë propozuar për sektorët e tjerë përfshijnë edhe një rol më të madh të shoqërisë civile, por edhe të qytetarëve, duke nisur me edukimin e qytetarëve për mënyrën se si duhet luftuar dhe parandaluar korrupsionin. Gjithsesi, faleminderit për këndvështrimin dhe optikën tuaj dhe do të përpiqemi t'i reflektojmë në dokumentin e analizës!

Faleminderit!

Fjala për zonjën Kryetare.

Elisa Spiropali - Shumë faleminderit, e dashur!

Të nderuar ekspertë,

Të nderuar anëtarë të komisionit,

I nderuar zoti Xhafaj,

Zonja e zotërinj,

Vendosa të marr pjesë me shumë kënaqësi në këtë takim të komisionit të posaçëm për dy arsye: e para, për të dëshmuar mbështetjen dhe inkurajimin maksimal të Kuvendit të Shqipërisë, por edhe timin personalisht, për veprimtarinë e komisionit “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Europian” dhe e dyta, për të dëshmuar rëndësinë që Kuvendi i Shqipërisë po i kushton luftës kundër korrupsionit, si një nga prioritetet e kësaj legjislature, të cilën e nënvizova edhe në çelje të sesionit tonë parlamentar.

Sigurisht, sot kam ardhur më shumë për t’ju dëgjuar sesa për të folur. Po ashtu, ju kërkoj ndjesë për mungesën në pjesën e parë, për shkak të një angazhimi zyrtar!

Ju kam ndjekur dhe dëgjuar me shumë vëmendje për të gjitha temat që diskutoni në komision, në të gjitha tryezat, por sidomos për çështjen e sotme, për luftën e suksesshme kundër korrupsionit, por edhe përpjekjet institucionale të koordinuara për këtë luftë, e cila përbën, besoj unë, thembrën e Akilit në përpjekjet tona për të ndërtuar një vend me ekonomi të fortë, sektorë dhe tregje konkurruese dhe një shoqëri me drejtësi sociale dhe solidaritet njerëzor. Jam veçanërisht e interesuar t’ju dëgjoj dhe të lexoj të gjitha ato që ju keni thënë apo edhe ato që keni shkruar, jo vetëm këtu në Kuvend, por besoj se kjo vlen për të gjithë qytetarët që na dëgjojnë dhe ju kanë dëgjuar me shumë vëmendje në të gjitha tryezat e organizuara.

Që me marrjen e detyrës, e kam ndjekur me shumë vëmendje dhe përgjegjësi veprimtarinë tuaj, jam njohur edhe me draftet dhe dokumentet që keni përgatitur, dhe e vlerësoj vizionin, realizmin, konstruktivitetin, kompetencën profesionale dhe institucionale në hartimin e tyre. Aty nuk ka aspak cinizëm, por ka një përpjekje serioze për të bërë ndryshimin përmes punës së përbashkët, por edhe dijes së secilit prej jush.

Jam informuar në vijimësi për veprimtarinë e komisionit dhe ju përgëzoj për përkushtimin dhe këtë energji që vini në dispozicion të Kuvendit të Shqipërisë, por edhe të një përpjekjeje

institucionale dhe shoqërore për të adresuar tri çështjet kryesore: mirëqeverisjen, antikorrupsionin dhe sundimin e ligjit.

Falënderimi shkon në radhë të parë për ekspertët që na janë bashkuar në këtë nismë për të përshpejtuar ecjen e Shqipërisë drejt Bashkimit Europian, që është edhe qëllimi final. Ne jemi në një moment shumë të mirë të integritetit në Bashkimin Europian, kemi çelur zyrtarisht kapitujt për Themeloret, ku sigurisht është edhe sundimi i ligjit, presim konferencën e tretë ndërqeveritare për çeljen kapitujve të tjerë apo grupkapitujve dhe besoj se deri në fund të vitit 2025 do të kemi çelur zyrtarisht negociatat edhe për kapitujt e tjerë. Pa diskutim që ekspertiza, kontributi, konsultimi me ju, jo vetëm sot, por edhe në të ardhmen, është një burim dijeshe dhe përvojash, që jo vetëm e pasurojnë këtë proces si një vlerë të shtuar, por na ndihmon të fokusohemi edhe në çështjet konkrete dhe jetësore për shoqërinë tonë.

Falënderoj, po ashtu, Delegacionin e Bashkimit Europian në Shqipëri, ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si dhe të gjithë partnerët ndërkombëtarë dhe ekspertët e huaj për format e ndryshme të mbështetjes që i kanë dhënë këtij komisioni dhe Kuvendit të Shqipërisë.

Në këta 4-5 muaj të veprimtarisë intensive të komisionit, Kuvendi është shndërruar në një kantier pune dhe debati, kryesisht nga veprimtaria dhe puna juaj. Nuk është rastësi që në ligjërimin publik, politik e parlamentar ky komision njihet shkurt si “komisioni i antikorrupsionit”, edhe pse nuk është vetëm i tillë. Sigurisht, gjuha shkon aty ku dhemb dhëmbi, te çështjet më kardinale, siç thotë populli, dhe kjo vlen edhe për këtë rast.

Pritshmëria popullore për luftën kundër korrupsionit ka krijuar këtë perceptim publik për qëllimin e korrupsionit dhe sigurisht që priten edhe përgjigje, zgjidhje dhe iniciativa administrative e ligjore edhe për të ardhmen.

Sigurisht, veprimtaria e komisionit është e gjerë, është një proces i gjerë konsultimi, diskutimi, debati, në funksion të qeverisjes më të mirë, përmirësimit të shërbimeve publike, rritjes së integritetit të funksionarëve dhe punonjësve publikë, përmirësimit të veprimtarisë së institucioneve dhe agjencive shtetërore dhe institucioneve të pavarura, ndërtimit të një Shqipërie më të fortë, me një shoqëri më të drejtë, ku qytetarët ndihen dhe janë zotër të vendit të tyre, të Kuvendit të tyre, pse jo, të qeverisë së tyre, të institucioneve të tyre,

Në fund të fundit, qëllimi final i qeverisjes dhe i të gjitha reformave në të cilat është përfshirë shoqëria shqiptare është rritja e mirëqenies së qytetarëve. Korrupsioni nuk është thjesht një e keqe, por është një pengesë për arritjen e çdo qëllimi tjetër në një vend demokratik. Sot ju

keni diskutuar dhe do të vijoni të diskutoni çështje kundër korrupsionit në sektorët me risk më të lartë. Arritjet e Shqipërisë në luftën kundër korrupsionit janë të dukshme dhe të matshme dhe vlerësohen vit pas viti nga raportet e Departamentit të Shtetit apo progresraportit të Komisionit Europian, por, që të jemi realistë, mjaft prej sektorëve me ndjeshmëri të lartë vazhdojnë ende të jenë me risk më të lartë ndaj korrupsionit dhe aty ka nevojë që të fokusohen dhe prezantohen tezat për diskutim dhe për plan veprimi në të ardhmen.

Veçoj në këtë kontekst problemet e pronësisë, që do të ishte një tryezë e posaçme për këtë çështje, apo të prokurimeve publike, që po diskutohen sot, e të tjera, për të cilat sigurisht që ekziston edhe një pritshmëri publike për përmirësim të situatës, por edhe gjetjen e zgjidhjeve më të duhura, se ndonjëherë nuk është çështje vullneti dhe dëshire, por është edhe çështje dijesh, kapacitetesh, angazhimesh, financash, buxhetesh, e me radhë.

Sigurisht, si Kryetare e Kuvendit ju sugjeroj që komisioni t'u rekomandojë edhe institucioneve shtetërore, siç keni bërë, strategjitë e zhvillimit të sektorëve, por edhe të bëjë rolin e vet, që është monitorimi dhe kontrolli i këtyre institucioneve, që nuk ndodh vetëm përmes komisionit të posaçëm, por duhet të shtrihet më pas edhe në veprimtarinë e komisioneve të tjera në bazë të një plani veprimi shumë të qartë.

Pra, duhet që në planet tona zhvillimore të mos lëmë shteg për abuzime dhe abuzuesit. Sigurisht, prokuroria është hallka fundore e luftës kundër korrupsionit, por ka një sërë masash që mund të merren për të ngushtuar hapësirat administrative, institucionale, ligjore, për t'i mbyllur shtigjet korrupsionit në shumë mënyra të tjera. Ky është kusht i domosdoshëm për eficiencën e institucioneve dhe agjencive publike. Jam njohur me disa prej rekomandimeve tuaja për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit në administratën qendrore dhe vendore, me fokus të posaçëm në sektorët konsideruar me risk të lartë. Ne do t'i shqyrtojmë ato me shumë vëmendje. E di që do të dilet më pas në një plan veprimi shumë të qartë, sepse korrupsioni nuk luftohet as me bujë, as me deklarata, as me politizim të skajshëm të retorikës publike, por luftohet me ligje, me mekanizma, procese dhe veprime efikase, që u bien në kokë si hapësirave që mundësojnë korrupsionin, ashtu edhe individëve të korrumpuar, pa diskutim.

Sigurisht, pyetjet që shtrohen janë:

Cilët janë këta mekanizma që plotësojnë pritshmëritë e publikut dhe qytetarëve? Cilët mekanizma të rinj duhet të krijojmë? Çfarë ndryshimesh ligjore duhet të bëjmë dhe në cilat duhet angazhuar Kuvendi? Si duhet të forcohet roli monitorues dhe kontrollues i Kuvendit?

Janë një sërë pyetjesh për të cilat unë, pa diskutim, pres përgjigje edhe nga ky komision, i cili duket se e ka shtruar rrugën deri në një plan veprimi, që besoj do të marrë edhe vëmendjen maksimale të publikut për çështje me kaq rëndësi për të.

Ju falënderoj shumë dhe suksese!

Jonida Rustemaj - Zonja Kryetare, faleminderit për ndjekjen nga afër të punës së komisionit, për sugjerimet dhe mbështetjen ndaj ekspertëve!

Fjala për zonjën Ardita Seknaj, nga ICC Albania.

Ardita Seknaj - Përshëndetje!

Faleminderit!

Unë do të fokusohem pak më shumë te pjesa e investimeve, meqenëse është një fushë që e ndjekim më nga afër. Jemi shumë dakord me të gjitha rekomandimet që janë dhënë dhe ndoshta për të ardhur më shumë me një sugjerim në këtë drejtim, ka ardhur momenti që mbas kaq vitesh, që janë në fuqi dy ligje, një për investimet e huaja dhe tjetri për investimet strategjike, të cilët pësojnë ato shtyrjet e veta, të kemi një tryezë diskutimi për të krijuar një harmonizim më të mirë të të gjithë kuadrit ligjor, ndoshta edhe institucional së bashku, për sa u takon investimeve, që të mos fokusohemi vetëm tek investimet strategjike. Në këtë mënyrë mund të jetë pak më e thjeshtë për të kuptuar se cilat janë pikat hyrëse, nevrologjike për subjekt të korrupsionit apo akteve korruptive.

Jo më larg se sot në mëngjes po diskutonim edhe për një nismë deputeti që ka të bëjë me shqyrtimin e investimeve të huaja në Shqipëri, është një nismë shumë e rëndësishme, e cilat duhet të marrë kohën e vet për t'u diskutuar me palët e interesit. Kjo nismë duhet harmonizuar në të njëjtën kohë me ligjet që kanë të bëjnë me investimet, sepse një ligj që është krijuar shumë vite më parë... sot ka pasur zhvillime sidomos në fushën e teknologjisë dhe sigurisë kibernetike, të cilat mund të kenë ndikime, edhe në sigurinë kombëtare, edhe në rendin publik, pra, është e mira që këto të vijnë në harmonizim dhe jo vetëm këto, por edhe me ligjet e tjera, por edhe me aspekte sektoriale të tjera që prekin sektorët madhorë me risk të lartë.

Një sugjerim që ne e kemi bërë si organizatë prej vitesh, por mbase është edhe momenti, ka të bëjë me një praktikë të mirë ose me një instrument të OECD-së, që është “Udhëzuesi për shumëkombëset” dhe pavarësisht se do të dojë një vullnet politik për ta miratuar dhe ratifikuar, në brendësinë e tij ka disa mekanizma që i ofrohen veçanërisht sektorit privat dhe investitorëve të huaj, në mënyrë që të krijohet ai mekanizmi që në anglisht quhet *grievance*, por në shqip nuk e

gjej, pra i shkartisjes së problematikës pa shkuar në gjykata, por që ti të trajtosh problematikë dhe ndër to është edhe fusha e antikorruptionit. Ndoshta kjo është një praktikë për të cilën ka ardhur momenti që ne ta marrim në shqyrtim në nivel makro edhe këtë pjesë, sepse mund të jetë diçka që mund të ndihmojë në procesin e mëvonshëm sa i takon përthithjes së investimeve kualitative, cilësore në vend.

Jonida Rustemaj – Faleminderit, zonja Seknaj, për sjelljen në vëmendje të këtyre sugjerimeve, që sigurisht do të rishikohen dhe do të pasqyrohen nga grupi i punës!

Nuk e di, ka ndonjë pjesëmarrës tjetër që dëshiron të ndajë këndvështrimin e tij ose të saj?
Po, zoti Dyrmishi.

Faleminderit!

Arjan Dyrmishi – Përshëndetje të gjithëve!

Faleminderit për prezantimin!

Në fakt, duke pasur parasysh të gjitha tryezat, mendoj se kjo është tryeza që fokusohet më shumë në sektorin privat. Për këtë arsye, duke pasur parasysh, gjithashtu, edhe ndikimin që theksojnë një sërë raportesh, qoftë të Europol-it, qoftë të Zyrës së OKB-së për Krimin dhe Drogat, për ndërlidhjen që ka krimi i organizuar me korrupsionin, shumica e organizatave të krimit të organizuar mbi 80%, sipas vlerësimeve më të fundit të Europol-it, edhe në zonën e Bashkimit European, përdorin biznesin si formë për të pastruar paratë. Pikërisht sektori privat që është një pikëprerje. Ai që faktikisht në momentin e tregjeve të paligjshme quhet “krimi i organizuar”, në momentin kur hyn në tregun e ligjshëm, merr formën e korrupsionit dhe, si të thuash, është një lloj pikëprerjeje, për të cilën mendoj se është kjo tryezë dhe ky raport do të duhej ta theksonte. Sigurisht, ky komision nuk merret veçanërisht me krimin e organizuar, por faktikisht ka një korrelacion të drejtpërdrejtë midis ndikimit dhe kjo reflektohet pastaj edhe në cenimin e konkurrencës në sektorin privat. Shumë nga hetimet më të fundit në Shqipëri, por edhe raporti, siç e thashë, e vë theksin te kjo problematikë dhe mendoj se mund të duhet të reflektohet.

Jonida Rustemaj – Faleminderit për sugjerimin tuaj!

Në fakt, një pjesë e çështjeve janë prekur edhe në aspekte të tjera të punës së komisionit, sepse këtu fokusi ka qenë vetëm në veprimtari të caktuara, prokurimet, koncesionet, por pjesa e sektorit privat në të cilën është kërkuar rritja e transparencës edhe identifikimi i pothuajse të gjithë...

Arjan Dyrmishi – E kuptoj, por në raport te sektorët me risk, përveç sektorëve publikë, ekziston edhe sektori privat dhe sektorit privat, si të thuash, më shumë i vendoset barra për sa i përket integritetit brenda sektorit, por kjo që unë parashtrova më tepër është në qasje për mbrojtjen. Pra, nëse e shikojmë sektorin privat si një sektor që ka nevojë për mbrojtje nga institucionet publike, nga interferimi dhe në këtë rast, po them që ne nuk e dallojmë, sepse merr formën e korrupsionit, por, nga ana tjetër, është krim i organizuar dhe diku duhet parë, domethënë nuk është në agjendën tonë, mbase s’është për këtë tryezë...

Jonida Rustemaj – Faleminderit për sugjerimin!

Po, zoti Moçka, fjala për ju.

Odise Moçka – Përshëndetje të gjithëve!

Faleminderit për ftesën!

Unë dua t’ju përgëzoj për punën tuaj dhe pavarësisht se nuk prekem drejtpërdrejt, kam një shqetësim që dua ta ndaj. Te raporti juaj është shumë e rëndësishme të dallohet që në hyrje përparimi që ka bërë vendi ynë në luftën kundër korrupsionit. Këtë e them edhe në rolin e titullarit, por edhe në rolin e qytetarit të thjeshtë për shkak se ndër vite, nëse nëpër medie apo nëpër raporte theksojmë që Shqipëria vazhdon luftën ndaj korrupsionit ose pikat e nxehta janë këtu, krijohet një përshtypje edhe te njerëzit. Konkretisht, ajo që unë dëgjoj sot nga njohjet ose kur bie në kontakt me njerëzit, është që, nëse një njeriu i thua që je caktuar anëtar komisioni për një prokurim, thotë: “Unë lë punën dhe iki që këtu”, domethënë, pa i thënë fare se çfarë do të ndodhë. Pra, ne duke dashur t’i japim rëndësinë një problemi që ka shoqëria, po tentojmë të prekim edhe ata njerëz që kanë integritet, të cilët janë të trembur dhe thonë: “Mos më ngatërro me prokurimet, se e kam siklet të madh”. Pra, ideja është që në fund të tryezës dhe tek ai raport, besoj se është më mirë që kjo të quhet një shtytje e mëtejshme ose perfeksionim i luftës apo i strategjisë sonë për të arritur atje ku është më e mira, për shkak se, nëse ne i japim të njëjtën rëndësi përditë sikur të jemi akoma para 30 vjetëve, edhe njerëzve u krijohet perceptimi sikur këtu asgjë nuk ndryshon, ndërkohë që janë bërë shumë punë të mira, janë digjitalizuar shumë veprime, janë shumë procedura të tjera që asnjëherë nuk janë përbuzur ose të ketë përshtypje negative për to. Qoftë edhe te puna që unë drejtoj, shikoj që në shumë çështje gjyqësore, në të cilat fiton shteti ynë, shikoj një administratë shumë të mirë. Tani, çfarë ndodh? Nëse njerëzit humbasin diçka, krijojnë menjëherë perceptimin që unë humba, këtu janë të korruptuar dhe mua nuk më dhanë të drejtë.

Pra, ideja është që tek ai raport ju keni shumë të dhëna dhe sigurisht këto që them unë s'janë baza, por është shumë e rëndësishme që në njërën anë të nxjerrim problemin dhe, nga ana tjetër, të theksojmë që kemi superpërparim, sepse është e domosdoshme edhe për njerëzit që kanë një integritet, që kanë një përvojë të gjatë, sepse thjesht fjala, duke i konsideruar si grupi i njerëzve që punojnë në sektorë me risk të lartë, e quajnë veten të prekur edhe nga kjo gjë. Kjo, për shkak se individit duke dëgjuar që, nëse merresh me këtë gjë, do të kesh probleme ndonjë ditë, atëherë kushdo që është person i lirë thotë: “Pse të merrem unë? Nuk po i futem fare kësaj gjëje dhe jam shumë në rregull në jetën time”. Kështu që, thjesht e kisha si sugjerim, të paktën njerëzor, se kemi ecur mirë besoj.

Faleminderit!

Jonida Rustemaj – Faleminderit!

Në fakt, për efekt kohe ne nuk e ndamë progresin dhe arritjet që janë realizuar ndërkohë, por sigurisht ato janë pjesë e dokumentit që është hartuar dhe që është ende draft. Nëse ju keni sugjerime të tjera edhe për progresin, edhe për arritjet, janë të mirëpritura, por sigurisht që janë pjesë, sepse nga aty ne jemi nisur për të bërë diçka më shumë.

Faleminderit!

Në mbyllje të tryezës po ia kaloj fjalën zotit Jaka.

Nikolin Jaka – Pra, duhet të vazhdojnë tryezat, pasi është shumë e rëndësishme që të marrim në trajtim problematikën që kanë sot proceset e shqyrtimit në Gjykatën Administrative. Pra, ka procedura të sipërmarrjes private dhe të qytetarëve, sepse çështjet e Gjykatës Administrative i krijon gjithmonë administrata publike në 90% të rasteve. Sot e kësaj dite ne kemi çështje që mund të presin prej 3 apo 5 vjetësh të pashqyrtuara nga njëra shkallë në shkallën tjetër. Ne jemi të gjithë të vetëdijshëm që, kur filloi iniciativa për Gjykatën Administrative, objektivi ishte që të kishte një afat minimal në shqyrtimin e çështjeve. Mirëpo, nga ana tjetër, duhet bërë një analizë. Duke qenë administrata publike prodhuese e të gjitha këtyre çështjeve në Gjykatën Administrative dhe, nga ana tjetër, prapë Agjencia e Monitorimit të Aktiviteteve të Administratës Publike mungon në shumicën e rasteve, kur çështjet fitohen në Gjykatën Administrative nga palët që janë kundërshtarë me administratën, nuk ka asnjë masë, nuk ka asnjë lloj reagimi për atë që ka krijuar të gjithë këtë maratonë të zgjidhjes së problematikës deri në 7-8 vjet, gjë që ka një kosto të jashtëzakonshme për sipërmarrjen, por ndërkohë ka një kosto edhe për buxhetin e shtetit, edhe për administratën publike.

Kështu që, përpos asaj që transmetoi zotëria në fjalën e tij, është shumë e vërtetë që ne duhet ta inkurajojmë administratën publike, në radhë të parë, që të jetë në nivelin e duhur të integritetit për të marrë vendime, sepse edhe mosveprimi është një problem tjetër. Unë ju siguroj që shumë shpejt sipërmarrjet do të reagojnë për mosveprimin e administratës publike, duke e trajtuar si vepër penale, sepse mosveprimi dhe veprimi njësoj janë. Kështu që, kur nuk vepron, domethënë që krijon përsëri një dëm tjetër, është e padiskutueshme. Pra, ne duhet ta inkurajojmë administratën publike dhe ngelet për të trajtuar rolin e KLSH-së. Në të gjitha komunikimet që ne kemi me institucionet qendrore thuhet që s'na lë KLSH-ja. Kush është KLSH-ja? Administrata duhet të respektojë dhe të zbatojë ligjin. KLSH-ja është një organ që jep opinionet e veta, por në asnjë rast KLSH-ja nuk mund të jetë ekzekutive dhe KLSH-ja përballet në gjykatë me administratën nga njëra anë dhe palën e dëmtuar nga ana tjetër. Në qoftë se KLSH-ja i ka fituar rastet në gjykatë, atëherë duhet të merren si precedencë, por jo KLSH-ja të jetë si e vetmja shprehje që thuhet sot nga administrata publike kudo: “Jo, se kur të kemi kontrollin e KLSH-së, na e nxjerr shkelje”. Zotëri, ka një ligj që duhet ta respektosh; ka një ligj sipas të cilit duhet të veprosh në zbatim të ligjit. Pra, duhet të jetë sundimi i ligjit i pari dhe pastaj urdhrat e shefit apo urdhrat e KLSH-së.

Jonida Rustemaj – Faleminderit për ndërhyrjen!

Nuk e di, a ka pjesëmarrës të tjerë të interesuar për të marrë fjalën?

Atëherë, në përmbyllje të kësaj tryeze po ia kaloj fjalën zonjës Etilda Gjonaj.

Etilda Gjonaj – Faleminderit, Jonida, së pari për moderimin, sepse e di që je me laringit dhe kishe probleme sot edhe me zërin!

Falënderoj shumë edhe të gjithë ekspertët që prezantuan gjetjet e tyre, pasi është shumë e vështirë dhe shumë sfiduese të prezantohen në një kohë kaq të shkurtër, por më besoni që i gjithë dokumenti, draftanaliza që është përgatitur, përmban një sërë çështjesh që u ngritën edhe nga pjesëmarrësit këtu.

Së dyti, dua t'ju falënderoj për kontributin tuaj dhe jo vetëm në këtë tryezë, por në të 11 tryezat, duke përfshirë edhe këtë të sotshmen, pasi ka qenë një proces maratonë. Këtu vërtet gjej rastin t'ju falënderoj të gjithëve, që në një kohë shumë të ngjeshur keni gjetur mundësinë që të vini, të jeni pjesëmarrës aktivë, të jepni kontributin tuaj nëpërmjet komenteve, sugjerimeve dhe vërejtjeve, të cilat pa dyshim do të jenë pjesë e asaj pune shumë të detajuar që edhe sekretariati

teknik po bën, duke i përfshirë në një dokument të posaçëm të gjitha këto sugjerime që ju keni ndarë me ne gjatë të 11 tryezave.

Deri tani pothuajse kanë marrë pjesë rreth 700 pjesëmarrës në të 11 tryezat, pjesëmarrje që ka qenë një kontribut dhe një vlerë e shtuar, ku ekspertët sipas çdo komponenti dhe sipas çdo shtylle, do t'i marrin dhe do të reflektojnë sugjerimet në dokumentin e tyre, me qëllim që jo vetëm të adresojnë çështjet që janë ngritur nga ju, por, nga ana tjetër, edhe të përmirësojnë dokumentonin final që jepet nëpërmjet këtyre sugjerimeve si një vlerë e shtuar. Kjo është tryeza e fundit e këtij formati në këtë proces, në këtë fazë, pasi menjëherë pas tryezës së sotshme, këtë javë, do të fillohet me forumet, me diskutimet nëpër qytetet të tjera të Shqipërisë, me grupe interesi, me studentë, me pedagogë, me shoqëri civile, me qytetarë, me institucionet lokale atje, me qëllim që të arrihet të përthithet mendimi, sugjerimet edhe nga pjesa tjetër.

Unë besoj se deri në fund të këtij procesi, të fazës së parë, që ka të bëjë me dokumentin analitik dhe ndërhyrjet kryesore që do të shërbejnë për masat e Planit Kombëtar të Veprimit, ne pa dyshim do të kemi mundësinë, por edhe vetë grupi i ekspertëve, do të jetë në komunikim, në kontakt me ju edhe për të kuptuar më shumë elemente, veçanërisht në ato raste kur ka pasur sugjerime që vijnë nga praktika, vijnë nga perceptimi, por vijnë edhe nga situatat konkrete.

Dua, gjithashtu, të falënderoj në këtë tryezë edhe ekspertët që kanë qenë pjesë e të gjitha shtyllave dhe të gjitha tryezave, jo vetëm për angazhimin e tyre shumë dinamik, por edhe të ngjeshur gjatë këtyre 5 muajve punë, por, njëkohësisht, edhe për kontributin e tyre profesional, pasi i kanë dhënë këtij procesi reformues që ne duam të ndërmarrim jo vetëm objektivitetin dhe paanësinë e paraqitjes së problematikave në këtë dokument, por, nga ana tjetër, edhe në atë çfarë konsiderohet zgjidhje nga aktorë të shoqërisë civile, nga Akademia, nga shoqatat e biznesit apo edhe nga institucionet e pavarura, duke përfshirë këtu edhe grupet e interesit. Unë besoj se në këtë moment kaq të rëndësishëm që jemi ne si vend, në kuadër të procesit të integritit evropian, ky është një kontribut i jashtëzakonshëm që i bëhet vendit dhe qytetarëve të këtij vendi.

E fundit fare, më lejoni, jo për forcë zakoni, dua të bëj një falënderim për stafin e Kuvendit, i cili në kohë rekord ka zhvilluar këto tryeza, duke u dhënë mundësinë të gjithë atyre që janë të interesuar dhe që mund të jenë të interesuar, grupeve të interesit, të jenë pjesë e këtyre tryezave, për të garantuar njëkohësisht dhe ato që ne i kemi parimet kryesore të këtij komisioni, transparencën dhe gjithëpërfshirjen.

Falënderoj drejtoreshën, zonjën Luzi, dhe të gjithë ekipin e saj, pa dashur të përmend emra!

Pa dyshim, në fund dua të bëj një falënderim për të gjithë ekspertizën ndërkombëtare që ka qenë pjesë e këtyre tryezave dhe pa dyshim, me gjithë grupet e ekspertëve, mezi presim të përfitojmë edhe nga *feedback*-u i ekspertizës ndërkombëtare që ndodhet në Shqipëri, edhe prej atyre që janë në vende të tjera.

Në fund fare, një falënderim edhe për përkthyesit, për vështirësinë e terminologjisë, që kanë lehtësuar pikërisht këtë komunikim edhe në gjuhë të huaj.

Faleminderit edhe një herë!

Jonida Rustemaj – Fjala për ju, zoti Xhafaj.

Fatmir Xhafaj - Jo, nuk kam fjalë, se foli kryetarja, foli edhe zonja Gjonaj, për sa i përket komisionit, por kam dy reflektime.

Reflektimi i parë lidhet me kërkesën e zotit Jaka. Kam një përshtypjen që është në sintoni edhe me vlerësimet shumë kuptimplota të ministres dhe ndoshta ne mund të organizojmë një tryezë të posaçme. Bie dakord, nuk e kishim menduar. Në fund fare, për çfarë jemi këtu? Për të reflektuar edhe ky është një lloj refleksioni. Ndoshta ne mund të përgatisim një tryezë të përbashkët, meqenëse kemi çështje që lidhen me korrupsionin, çështje që lidhen me qeverisjen, çështje që lidhen me sundimin e ligjit, do të kemi një komponent të veçantë që lidhet edhe me sistemin e drejtësisë për shqetësimet që ngritët ju, lidhur me Gjykatën Administrative dhe të tjera. Ndoshta mund ta mendojmë këtë shumë shpejt, konceptojeni ju, si të jetë më mirë dhe unë besoj se do të jetë shumë përfituese për ne, për të dëgjuar shqetësimet, por edhe për të bërë reflektimet e nevojshme.

E dyta, dëgjova me shumë interes ndërhyrjen e zotit Ferruni, në mos gaboj, nga shoqëria civile, paçka se unë s'ndaj të njëjtin mendim për ndonjë element, por prandaj jemi këtu në tryezë, se mund të kemi edhe pozicione të ndryshme, ky është edhe qëllimi, unë mendoj se kishte gjëra me interes. Ne nuk e kemi parë nga ky këndvështrim. Jeni i lutur, nëse do të mundeni, të na jepni një opinion që si mund ta reflektojmë ne këtë te draftet tona dhe si mund ta reflektojmë pastaj te Plani i Veprimit. Pra, ndërhyrja juaj në thelb është me interes, thashë, pavarësisht elementeve të veçanta që unë i shikoj nga një këndvështrim tjetër. Kështu që, për atë pjesë që ne gjykojmë se vlen, do të dëshironim të kishim një koment, nëse na i dërgoni, si organizata të shoqërisë civile, për ta pasuruar më tej edhe dokumentin tonë, pastaj edhe për ta reflektuar te Plani i Veprimit. Dhe

do t'ju ftonim, ju dhe shumë të tjerë që kanë marrë pjesë, por edhe ata që nuk kanë mundur, për arsye të ndryshme, të marrin pjesë në këto tryeza gjatë diskutimeve që kemi bërë, që të merrni pjesë në debatin që do të bëjmë për Planin e Veprimit, i cili praktikisht është thembra e Akilit e këtij projekti. Pra, do të dëshironim shumë të ishit, pasi të gjithë jemi shumë të etur dhe shumë të interesuar për të parë të gjitha këndvështrimet që mund ta ndihmojnë punën e ekspertëve, punën e komisionit në Planin e Veprimit.

Për këto dy ndërhyrje, kërkoj ndjesë! Unë s'para ndërhyj, por i pashë me shumë interes.

Jonida Rustemaj – Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Koordinator i Komisionit

Elvi Prifti